

**FATMIRA MUSAJ**

**ARSIMI NË SHQIPËRI DHE MASAT  
PËR PËRMIRËSIMIN E TIJ  
(1925-1928)**

**Gjendja arsimore në Shqipëri në vitin 1925**

Shteti i pavarur shqiptar në vitin 1912 nuk trashëgoi një sistem arsimor kombëtar, sepse në Shqipëri për afro pesë shekuj të sundimit osman, nuk u lejua shkrimi dhe këndimi në gjuhën shqipe. Pikënisje për ndërtimin e zhvillimin e tij ishte programi arsimor i qeverisë së përkohshme të Vlorës, në të cilin u parashikua hapja dhe organizimi i shkollës fillore shqipe, arsimit fillor u shpall i detyrueshëm për të dy gjinitë, u morën masa për hartimin e programeve e teksteve shkollore si dhe u hodhën bazat fillestare të ligjshmërisë arsimore etj.<sup>1</sup> Situata politike e brendshme dhe e jashtme në të cilën kaloi shteti shqiptar në tetë vitet e para të jetës së tij, ndikuan negativisht edhe në zbatimin e programit arsimor kombëtar.

Përvoja arsimore e qeverisë së Vlorës, u çua më tej nga qeveria e Lushnjës dhe qeveritë që e pasuan deri në vitin 1924. Në këtë periudhë u bënë përpjekje për kombëtarizimin, laicizimin dhe njësimin e strukturës dhe të përmbajtjes së shkollës shqipe. U zgjerua më tej rrjeti i shkollave fillore, u hodhën hapa në arsimin e mesëm për vajza e për djem. Por, mangësitë në zhvillimin e sistemit arsimor shtetëror ishin të ndjeshme për shkak të financave të varfra të shtetit dhe të mungesës së stabilitetit politik të vendit në vitet 1923-1924.

Qeveria shqiptare në vitin 1925 ndeshi në një sërë problemesh në fushën e arsimit. Të dhënat statistikore për vitin shkollor 1924-1925, dëshmojnë për ngadalësinë e zhvillimit të arsimit nga Shpallja e Pavarësisë deri në vitin 1925.<sup>2</sup> Shtirirja e rrjetit të shkollave shtetërore

---

<sup>1</sup> *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, vëll. I, botim i Institutit të Studimeve Pedagogjike, Tiranë: 2003, f. 265.

<sup>2</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F) 195, viti (më tej: V) 1926, dosja (më tej: D.) 5, fl. 37-47. Për ecurinë e arsimit në Shqipëri nga koha e Shpalljes së Pavarësisë e deri në vitin 1924 shih në: Fatmira Musaj, *Gruaja në Shqipëri në vitet 1912-1939*, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë: 2002, f. 222.

fillore ishte e kufizuar. Në të gjithë vendin funksiononin 447 shkolla të tilla, që mbulonin jo më shumë se 20 % të fshatrave të Republikës Shqiptare. Ajo ishte edhe më e ulët në zonat veriore dhe verilindore të vendit. Kështu nënprefektura e Matit kishte shkolla në 13% të fshatrave, ajo e Zerqanit në 14% dhe të Pukës në 10% të tyre.<sup>3</sup> Ndërsa, në prefekturën e Beratit, ato mbulonin 21% të fshatrave, dhe në atë të Korçës kishte shkolla në 38.5% të tyre.<sup>4</sup> Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkolla ishte 25.241 ose 3.04% e numrit të përgjithshëm të popullsisë, prej të cilëve 4052 ishin nxënës.<sup>5</sup> Mungesa të theksuara vëreheshin edhe në personelin mësimdhënës. Në të gjithë vendin ishin 757 mësues (108 ishin femra), të cilët nuk u përgjigjeshin kërkesave të shkollave ekzistuese.<sup>6</sup> Në rritjen e numrit të tyre ndikonte ritmi i ulët i përgatitjes së arsimtarëve. Sipas të dhënave të raporteve të drejtorive arsimore, del se në të gjithë prefekturat e vendit ishin çelur dhe funksiononin shkolla fillore 2-3 klasëshe, plotore për meshkuj dhe për femra, dhe të përziera. Ndonëse arsimi fillor ishte i detyrueshëm, frekuentimi i shkollave ishte i ulët. Sipas statistikës së vitit shkollor 1925-1926, në qarkun e Matit nga 551 nxënës të regjistruar në 15 shkolla, i frekuentonin rregullisht vetëm 381 ose 69.14% e tyre.<sup>7</sup> Në qarkun e Gjirokastrës në (shkollat kombëtare e grekofone), numri i nxënësve të regjistruar ishte 3368 (1226 vajza), prej tyre i ndiqnin ato rregullisht 2718 nxënës (990 vajza)<sup>8</sup>. Në qarkun Kolgecaj nga 1072 nxënës të regjistruar, ndiqnin mësimin 847 ose 79% e tyre.<sup>9</sup> Megjithëse Shkodra krahasuar me rrethe të tjera veriore kishte një numër të konsiderueshëm shkollash (16 shkolla shtetërore dhe private)

<sup>3</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1925, D. 37, fl. 2, 40, 164, 209, 229, 247, Statistika për gjendjen arsimore në prefekturat e vendit, mars 1925.

<sup>4</sup> *Po aty*.

<sup>5</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1926, D. 5, fl. 37-47; Shih edhe: F. Musaj, *Gruaja në Shqipëri...*, f. 222.

<sup>6</sup> *Po aty*.

<sup>7</sup> *AQSH*, F. 195, V. 1926, D. 1, fl. 8, Raport i drejtorisë arsimore Mat drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Arsimore, Mat, 3 maj 1926.

<sup>8</sup> *Po aty*, Raport i inspektorit të drejtorisë arsimore Gjirokastrës, Jani Minga, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Arsimore, Gjirokastrë, 7 prill 1926.

<sup>9</sup> *Po aty*, fl. 166, Raport i drejtorit të internatit "Kosova" drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Arsimore, Kolgecaj, 15 prill 1925.

numri i nxënësve që i frekuentonte ato ishte i ulët, 1226 djem dhe 785 vajza.<sup>10</sup>

Frekuentimi i ulët i shkollave nga nxënësit ishte rrjedhojë e shkallës së lartë të analfabetizmit të popullsisë, nivelit të ulët ekonomik sidomos në fshat, ku fëmijët detyroheshin të punonin në ekonominë familjare, mungesës së komunikacionit, konservatorizmit dhe fanatizmit si dhe puna e pamjaftueshme e organeve shtetërore ligjzbatuese për arsimin shkollor të detyrueshëm.

Gjendja e vështirë paraqitej edhe në arsimin e mesëm. Në qytetet më të mëdha të vendit si në Shkodër, Korçë, Elbasan, Gjirokastrë e Berat, funksiononin 6 shkolla të mesme, të përgjithshme dhe profesionale, prej të cilave njëra ishte për vajza.<sup>11</sup> Në këto shkolla jepnin mësim 64 mësues, prej të cilëve 6 ishin femra. Numri i përgjithshëm i nxënësve ishte 728 prej të cilëve 65 ishin femra.<sup>12</sup> Për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve të zonave të thella, ishin ngritur konvikte në Dibër, Kolgecaj (Krumë), Shkodër, Elbasan, Skrapar dhe Vlorë.<sup>13</sup> Nxënësit mbështeteshin me bursa nga shteti dhe më pas dërgoheshin si mësues në zonat e tyre.<sup>14</sup>

Në kushtet e një sistemi të paorganizuar dhe me mbështetje financiare të kufizuar, niveli arsimor i popullsisë ishte i ulët. Në analizën e drejtorisë arsimore të qarkut të Shkodrës theksohej se “gjendja arsimore e popullsisë është e mjerueshme. Nga 110 mijë banorë, 94% e kësaj popullsie janë injorant.”<sup>15</sup> Për përmirësimin e gjendjes sugjerohej vendosja e inspektorëve të zotë, për të forcuar kontrollin, për edukimin e rinisë. “Duhet marrë masa të rrepta për tërheqjen e vajzave të vogla në shkollë, theksonte drejtori i gazetës “Afrimi”, sepse do të mbetet tepër

<sup>10</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1926, D. 1, fl. 115, Relacion i inspektorit të arsimit në Shkodër drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Arsimore në Tiranë, Shkodër 13 maj 1926.

<sup>11</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1925, D. 37, fl. 2, 40, 164, 209, 229, 247, Statistika për gjendjen arsimore në prefektura të ndryshme të Shqipërisë, mars 1925.

<sup>12</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1926, D. 5, fl. 37-47; Shih edhe në: F. Musaj, *Gruaja në Shqipëri...*, f. 222.

<sup>13</sup> *AQSH*, F. 195, V. 1925, D. 37, fl. 2, 40, 164, 209, 229, 247, Statistika për gjendjen arsimore në prefektura të ndryshme të Shqipërisë, mars 1925.

<sup>14</sup> *Po aty*.

<sup>15</sup> *Po aty*, V. 1926, D. 3, fl. 336, Raport i Inspektorisë Arsimore Shkodër drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit në Tiranë, Shkodër, 13 maj 1926.

keq siç edhe ndodhet keq.”<sup>16</sup> E njëjta situatë paraqitej edhe në nënprefekturën e Tiranës. Në relacionin e drejtorisë arsimore të kësaj prefekturë theksohej: “... megjithëse e njohin rëndësinë e arsimit, kur vjen fjala për ta zbatuar, përveç se një pakicë njerëzish, pjesa tjetër e sheh këtë institucion të shenjtë gati të tepërt. Nëse nuk vihet në lëvizje kjo administratë, populli edhe për shumë kohë do të mbetet 96 % analfabet”.<sup>17</sup>

Në gjendjen arsimore të kësaj periudhe, negativisht ndikoi edhe situata politike e krijuar në vend e cila çoi në Lëvizjen e qershorit të vitit 1924. Arsimitarët, si pjesa më e përparuar e shoqërisë, mbështetën programin e opozitës liberal-demokrate, i cili premtojte ndërtimin e një Shqipërie demokratike, organizimin e arsimit kombëtar mbi baza moderne. Një pjesë syresh u angazhuan dhe morën pjesë drejtpërdrejt në Lëvizje për mbrojtjen e qeverisë së Fan Stilian Nolit nga sulmi i forcave të A. Zogut në dhjetor 1924.

#### **Masat e marra nga A. Zogu në arsim, pas rikthimit në pushtet**

Që në fillim të vitit 1925, përpara qeverisë shtroheshin për zgjidhje një sërë problemesh si: unifikimi i niveleve shkollorë, i programit mësimor në secilin nivel, rregullimi i godinave të përshtatshme për mësim, plotësimi i nevojave me arsimtarë të përgatitur me cilësitë e duhura për mësimdhënie, shtrirja e sistemit shkollor në të gjithë vendin etj. Pra kërkohesh hartimi e zbatimi i një strategjie të përcaktuar qartë dhe marrja e masave komplekse për zhvillimin e arsimit kombëtar. Por, A. Zogu në fjalën e tij para Kuvendit Kushtetues në janar 1925, më shumë se gjendjes së rëndë në arsim, i kushtoi vëmendje të veçantë implikimit të arsimtarëve në ngjarjet politike të gjysmës së dytë të vitit 1924. Sipas tij, arsimi kishte pësuar deformim dhe i ishte shmangur detyrës kryesore që ishte mësimi dhe edukimi i nxënësve. Shkolla ishte molepsur nga idetë e revolucionit. Për këtë gjendje ai fajësoi mësuesit. “Siç e dini Z. e Juaj, - iu drejtua ai anëtarëve të Kuvendit, - arsimi pat marrë udhën e ushtrisë. Fëmija 10 vjeç nuk mendonte tjetër vetëm koburë. Kjo vjen vetëm prej mësuesve. Ky mentalitet dhe influencë e politikës në shkollë duhet të

<sup>16</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1926, D. 4, fl. 3, Drejtori i gazetës “Afrimi” drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Arsimore, Vlorë 3 mars 1926.

<sup>17</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1925, D. 4, fl. 162, Gjendja arsimore në Tiranë, 11 shkurt 1926.

zhduket.”<sup>18</sup> Pikërisht largimi i punonjësve dhe mësuesve opozitarë dhe kthimi i shkollës në normalitet, u bë një nga drejtimet e reformës arsimore si pjesë e strategjisë së A. Zogut për të luftuar çdo ide që ishte kundër regjimit të tij. Për realizimin e një politike të tillë, qeveria shfrytëzoi dhe pakësimin e të ardhurave në buxhet për vitin 1925, të cilat bënë të detyrueshme shkurtime dhe shpenzimeve edhe për arsimin. Të ardhurat e këtij viti krahasuar me ato të vitit 1924, u ulën me 8. 334.035 fr.ar, ndërsa buxheti për arsimin u ul me 1.031.078 fr.ar.<sup>19</sup> Kjo ulje e të ardhurave ishte pasojë e situatës politike që kaloi vendi dhe prekjes së financave të shtetit nga ish zyrtarë të qeverisë së F. S. Nolit.<sup>20</sup>

Masa e parë për shkurtime u mor ndaj dikasterit më të lartë, Ministrisë së Arsimit (MA), duke e zbritur në nivel Drejtorie të Përgjithshme të Arsimit (DPA). Shkurtime që do të pasonin në strukturën administrative arsimore në të njëjtën kohë, do të largonin nga puna nëpunësit që kishin mbështetur Lëvizjen e qershorit të vitit 1924.<sup>21</sup> Madje seleksionimi do të shtrihej deri te arsimtarët, prej të cilëve do të përzgjidheshin mësuesit më të mirë dhe do të largoheshin “elementët më të dobët.”<sup>22</sup> Kthimi i MA në Drejtori të Përgjithshme, shënonte një hap prapa në zhvillimin e arsimit kombëtar. Problematika shumëplanëshe që qëndronte për zgjidhje në këtë fushë, kërkonte fuqizimin e këtij institucioni, sepse si Ministri, ajo kishte më shumë kompetenca e kapacitete njerëzore, për t’iu përgjigjur nevojave të ngutshme të arsimit.

Ndonëse theksohej kriteri politik në përzgjedhjen e kuadrove, A. Zogu duke njohur problemet që kishte arsimi, në drejtimin e administratës së tij, angazhoi specialistët më të njohur dhe me përvojë në këtë fushë. Në krye të DPA u emërua një ndër figurat më të shquara të arsimit të Korçës, (kryeinspektori i arsimit të qarkut), Sotir Papahristo, i cili varej nga kryeministri, ndërsa organikisht DPA u bë pjesë e Ministrisë së Drejtësisë.<sup>23</sup> Pranë DPA, u krijua një këshill konsultativ

<sup>18</sup> *Bisedimet e Kuvendit Kushtetues*, Viti 1925, mbledhja nr. 65, f. 891.

<sup>19</sup> Teki Selenica, *Shqipëria në vitin 1927*, Tiranë: Shtypshkronja “Tirana”, 1928, f. LIV.

<sup>20</sup> *Po aty*, f.141.

<sup>21</sup> *Bisedimet e Kuvendit Kushtetues*, Viti 1925, mbledhja nr. 65, f. 891.

<sup>22</sup> *Po aty*.

<sup>23</sup> *AQSH*, F.152, V.1925, D. 494, fl. 11, Dekretligj mbi suprimimin e Ministrisë së Arsimit; *Po aty*, V. 1925, D. 15, fl. 1, Telegram i Kryetarit të Republikës drejtuar ministrit të Drejtësisë P. Poga, Tiranë, 11 mars 1925; *Fletorja*

permanent, i cili do të përbëhej prej drejtorëve të shkollave e prej arsimtarëve më të sprovuar në çështjet arsimore. Për mungesë buxheti, ai do ta kryente punën pa shpërblim. Drejtorët e shkollave të mesme që gjendeshin jashtë Tiranës, do të merrnin pjesë në këshill vetëm 15 ditë, gjatë kohës së pushimeve. Mënyra e funksionimit të këshillit do të përcaktohej në një rregullore të veçantë.<sup>24</sup> Drejtoria e muzeut dhe e bibliotekës si pjesë strukturore e MA u suprimua. Njërit prej sekretarëve të DPA iu ngarkua detyra e përkujdesjes për to.<sup>25</sup>

Shkurtime në personelin e administratës arsimore u bënë në të gjithë vendin. U suprimuan zyrat e inspektorive të arsimit dhe u zëvendësuan me inspektorë shëtitës. U parashikua që përkohësisht të mos hapeshin shkolla-lice të reja por të mbështeteshin ato ekzistuese në Korçë e Gjirokastër. Për kushtet e vështira në të cilën gjendej godina e konviktit të Normales së Elbasanit, u parashikua që 65 bursistë të saj të kalonin pranë gjimnazit të shtetit në Shkodër. Parashikohej që godina e re të ndërtohej me paratë e dhuruara nga Agjah Libohova dhe Aladro Kastrioti. Shuma e dhuruar ishte 480 napolona flori.<sup>26</sup> Masë tjetër ishte suprimimi i Normales femërore në Korçë dhe në vend të saj do të ringrihej shkolla qytetëse femërore 8 klasëshe duke i shtuar edhe dy vjet studime të posaçme pedagogjike.<sup>27</sup> Me këtë synohej të kursehej qiraja e godinës dhe shtimi i personelit për plotësimin e Normales. U vendos rishikimi i bursave të brendshme e të jashtme për vitin shkollor 1925-1926, fondi i bursave të studentëve që përfundonin studimet nuk do t'u kalonte studentëve të rinj, ndërsa për studentët që nuk kishin përparimin e duhur në mësim, u kërkua që t'u pritej bursa.<sup>28</sup>

Veç shkurtimeve në administratë, A. Zogu e drejtoi vëmendjen edhe ndaj mësuesve. Ai u kërkoi inspektorive të arsimit në rrethe të pasqyronin

---

*Zyrtare*, Nr. 9, 13 mars 1925, fl. 2; *AQSH*, F. 195, V. 1926, D. 1, fl. 177. Raport për lehtësim të administratës e lehtësim të burokracisë. Pavarësisht se dokumenti është inkuadruar në vitin 1926, përmbajtja e raportit, mbi masat për shkurtime në këtë fushë, janë marrë në fillim të vitit 1925.

<sup>24</sup> *Po aty*.

<sup>25</sup> *Po aty*.

<sup>26</sup> *Po aty*, *Gazeta Elbasani* (49) 12, 7 vjeshtë e parë 1925, f. 1. Shkolla Normale.

<sup>27</sup> *AQSH*, F. 195, V. 1926, D. 1, fl. 177, Raport për lehtësim të administratës e lehtësim të burokracisë.

<sup>28</sup> *Po aty*, f. 180.

listat emërore të arsimtarëve mbështetës të tij të cilët ishin pushuar nga qeveria e F. S. Nolit, ose ishin detyruar të largoheshin jashtë vendit si dhe emrat e mësuesve që kishin mbështetur hapur Lëvizjen e qershorit ose kishin marrë pjesë në mbrojtje të qeverisë së F. S. Nolit në dhjetor 1924.<sup>29</sup> Për këtë qëllim u ngritën komisione pranë zyrave arsimore të prefekturave të cilët do të hartonin listat me emrat e arsimtarëve që duhej të qëndronin në detyrë, për të bërë të mundur vazhdimin e procesit mësimor për periudhën e mbetur të vitit shkollor 1924-1925. Veç shkurtimeve, ashtu si në tërë administratën edhe në arsim, për të prishur lidhjet e bashkëpunimet e mundshme për organizime kundër qeverisjes së vendit, u bënë transferime të inspektorëve dhe arsimtarëve nga një krahinë në tjetrën.<sup>30</sup> U propozuan për pushim nga puna kuadro të rëndësishëm të arsimit, të cilët ishin deklaruar mbështetës të F. S. Nolit si Mihal Sherko (drejtor i drejtorisë arsimore në Korçë), Thanas Floqi në Elbasan; u propozua për transferim mësuesja Elpiniqi Qamo në Përmet etj.<sup>31</sup> Nga të gjitha prefekturat erdhën në DPA listat me emra mësuesish ku kërkohej largimi i tyre nga puna me motivacionin si përkrahës “të nxehtë” të revolucionit.<sup>32</sup>

A. Zogu, megjithëse u informua nga drejtoritë arsimore të prefekturave se, “qeveria e Nolit nuk kishte larguar nga puna asnjë arsimtar kundërshtar të saj, apo të ishin detyruar për t’u larguar jashtë vendit”<sup>33</sup>, ai nuk e veçoi arsimin nga pjesa tjetër e administratës për spastrime të kundërshtarëve politikë. Me propozimet e ardhura nga autoritetet arsimore në prefektura, u pushuan nga puna 126 arsimtarë nga të cilët 24 në Gjirokastrë, 23 në Elbasan, 20 në Korçë, 17 në Durrës, 13

<sup>29</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1925, D. 4, fl. 2, 11, 12-13, Deklarime të inspektorëve në Durrës, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë dhe, i drejtorisë së internatit “Kosova” në Kolgecaj, përkatësisht më 3 janar dhe 14, 21, 25 shkurt 1925.

<sup>30</sup> *Po aty*, F.155, V. 1925, D. IX-2, fl. 4, Telegram i Kryesisë së Republikës, Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë, 12 shkurt 1925.

<sup>31</sup> *Po aty*, F. 155, V. 1925, D. IX-2, fl. 5, Telegram i Kryesisë së Republikës drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë, 17 mars 1925.

<sup>32</sup> *Po aty*, V. 1925, D. IX-3, fl. 6, Kërkesë e prefekturës së Elbasanit për pushimin nga puna të Th. Floqit, drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Elbasan, 11 prill 1925.

<sup>33</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1925, D. 166, fl. 25, Telegram i prefekturës së Gjirokastrës drejtuar zyrës sekrete në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Gjirokastrë, 22 janar 1925.

në Berat, 12 në Shkodër, 6 në Vlorë, 6 në prefekturën e Kosovës dhe 1 në Tiranë.<sup>34</sup>

Masat me karakter politik që u ndërmorën në fushën e arsimit, përveçse dëmtonin procesin mësimor, krijuan precedentin e futjes së frymës së përjashtimit dhe të përçarjes, në vend të bashkëjetesës e të bashkimit të shqiptarëve ashtu, siç pretendonte A. Zogu ta bënte shkollën. Kjo u vu re jo vetëm në gatishmërinë e disa zyrave arsimore dhe autoriteteve lokale për të goditur arsimtarët me bindje opozitare por edhe nga individë të veçantë të cilët i shërbyen me zell këtij procesi.

Kundër kësaj politike, reagan personalitete të shquara të arsimit kombëtar. Inspektori i Arsimit në Gjirokastrë, Jani Minga, plagët në arsimin shqiptar dhe çalimin në veprimtarinë e shkollave, i shihte si pasojë e emërimit të drejtuesve të pazot.<sup>35</sup> Ai shprehu rezerva ndaj kuadrit arsimor të parashikuar për vitin shkollor 1925-1926, për arsye se ishin hartuar për një kohë shumë të shkurtër pa u mbështetur në mbikëqyrjen e shkollave dhe pa njohur gjendjen reale të tyre. Duke folur konkretisht për shkollat e qarkut që mbulonte dhe veçoritë e tyre, ai theksonte se "...duhej të jemi të rreptë në emërimet e mësuesve në shkollat kombëtare, duhet të emërojmë mësues të zot të gjuhës shqipe e të greqishtes në shkollat grekofone e jo ata që nuk dinë shqip dhe paguhen nga shteti."<sup>36</sup> Ai kërkonte zbatimin e kritereve të forta për të shmangur çdo ndërhyrje të politikës, deputeti apo të "fortit të ditës" për emërimin e njërit apo tjetrit person në arsim si dhe të merrej mendimi i inspektorive se "ndryshe kjo zhvishet nga çdo përgjegjësi për gjendjen arsimore në këtë qark."<sup>37</sup> J. Minga kritikoi transferimet dhe pushimet e arsimtarëve nga puna në mes të vitit, emërimin e mësuesve pa u mbështetur në aftësinë profesionale e nivelin e tyre arsimor.<sup>38</sup> "Kemi qenë dhe jemi kundër çdo shpërngulje të arsimtarit e të pushimit të tij. Shpërngulja në mes të vitit, - theksonte ai, - veç dëmit nuk sjell dobi.

<sup>34</sup> *Po aty*, F.195, V. 1925, D. 42. fl. 78, Listë me emrat e arsimtarëve të larguar nga detyra; *Po aty*, F. 195, V. 1927, D. 21, fl.1-8, Lista emërore e arsimtarëve të pushuar nga puna në të gjithë Shqipërinë.

<sup>35</sup> *Po aty*, F.195, V.1925, D. 37, fl. 123, Raport i inspektorit të arsimit të Gjirokastrës, mbi listat e arsimtarëve për vitin shkollor 1925-1926, drejtuar DPA, Gjirokastrë, 21 korrik 1925.

<sup>36</sup> *Po aty*.

<sup>37</sup> *Po aty*.

<sup>38</sup> *Po aty*.

Nëse bëhet, të bëhet vetëm për shkak pazotësie ose për nevoja të mëdha të arsimit”.<sup>39</sup>

Edhe inspektori i arsimit të qarkut të Durrësit Zef Fekeqi, u përpoq të pengonte largimin e arsimtarëve nga puna për motive politike. Ai i propozoi DPA, që ndaj tyre të merreshin masa administrative (prerje rroge), sipas shkallës së angazhimit të tyre në ngjarjet e qershor – dhjetorit 1924.<sup>40</sup> Z. Fekeqi në bashkëpunim me kryepleqtë e zonës së Shijakut me fakte hodhi poshtë padinë e drejtorit të zyrës arsimore, ndaj arsimtarëve.<sup>41</sup> Propozimet e Z. Fekeqit jo vetëm që nuk u pranuan nga nënprefekti i Durrësit, por në telegramin që ky i fundit i drejtonte ministrit të Brendshëm Ceno Kryeziut, e akuzonte si një ndër drejtuesit kryesor të organizimit të rezistencës së mësuesve në dhjetor 1924 dhe kërkoi shkarkimin e tij nga detyra.<sup>42</sup> C. Beu ia përcolli propozimin Ministrisë së Drejtësisë, madje me këtë rast, kërkoi të viheshin nën kontroll të gjithë trupat mësimore në vend.<sup>43</sup> Masat me karakter politik të marra nga A. Zogu në administratë dhe në fushën e arsimit në veçanti, Mirash Ivanaj në letërkëmbimin me të vëllanë i konsideronte si përpjekje për të përqendruar pushtetin në një dorë të vetme dhe e cilësonte atë, si “Padre eterno”.<sup>44</sup>

Kritikat e bëra dhe gjendja në të cilën ndodhej arsimi në Shqipëri, kërkesat gjithnjë në rritje për shkolla dhe veçanërisht për arsimtarë, ndikuan te A. Zogu i cili në fund të vitit 1925 u detyrua të zbuste masat ndaj arsimtarëve, të cilët ishin propozuar për pushim nga puna apo transferime të pakushtëzuara nga nevojat e procesit mësimor. Ai ktheu disa propozime të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe e urdhëroi atë që arsimtarët e përfshirë në lista, të thirreshin e të

<sup>39</sup> *Po aty*.

<sup>40</sup> *Po aty*, F.195, V.1925, D. 42, fl. 1, Telegram i inspektorit të arsimit në Durrës Z. Fekeqi drejtuar inspektorisë arsimore Tiranë. Kjo e fundit ia drejtoi Ministrisë së Arsimit, Tiranë, 25 janar 1925.

<sup>41</sup> *Po aty*, fl. 2.

<sup>42</sup> *Po aty*, F. 152, V. 1925, D. 166, fl. 26, Telegram i nënprefektit të Durrësit, drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Durrës 12 shkurt 1925

<sup>43</sup> *Po aty*, F. 155, V. 1925, D. IX-3, fl. 6, Telegram i Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë 23 prill 1925: *Po aty*, fl.21. Telegram i Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, prill 1925.

<sup>44</sup> *Po aty*, F.433, V.1925, D. 36/1, fl. 20, Letër e M. Ivanajt drejtuar Martin Ivanajt, Tiranë 14 korrik 1925.

këshilloheshin për të hequr dorë nga politika dhe të merreshin me plotësimin e detyrës së tyre aq të rëndësishme. “U duhet theksuar, porosiste A. Zogu, se në rast përsëritje të veprimeve të tyre, do të merreshin masa serioze.”<sup>45</sup> Megjithatë për emërimë, riemërimë, transferime të mësuesve, krahas kriterit moral e profesional, për herë të parë u shtua edhe kriteri politik, i cili përmbante besnikërinë ndaj regjimit.<sup>46</sup>

### **Veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme Arsimore (1925- qershor 1927)**

Krijimi i sistemit arsimor unik kombëtar si elementi më i rëndësishëm i reformës arsimore, kërkonte angazhimin e specialistëve të aftë, me dije teorike e praktike dhe njohës të mirë të situatës arsimore në vend. Drejtori i DPA, S. Papahristo, në prill të vitit 1925, i paraqiti ministrit të Drejtësisë, rregulloren për formimin e një komisioni teknik.<sup>47</sup> Si kandidatura për komisionin ai propozoi personalitete të shquara të arsimit, si Leonidha Naçi (doktor në shkencat e matematikës e fizikës), dy normalistë e metodistë të shquar të arsimit, Gaspër Mikeli e Andon Paluca dhe një nga dijetarët më të mirë të gjuhës dhe me përvojë të gjatë në fushën e arsimit, Simon Shuteriqi. DPA pranoi në përbërje të komisionit teknik, S. Shuteriqin, G. Mikelin, M. Ivanajn, ndërsa L. Naçi do të merrte pjesë në mbledhjet e komisionit si i jashtëm.<sup>48</sup> Anëtarët e komisionit që ushtronin një nëpunësi, përveç rrogës, do të merrnin 200 fr.ar shpërblim, ndërsa anëtarët e përhershëm që nuk ushtronin nëpunësi, merrnin një rrogë prej 400 fr.ar në muaj gjatë kohës së funksionimit të komisionit.<sup>49</sup> Me vendim të Këshillit të Ministrave (KM), pranë

<sup>45</sup> *Po aty*, F. 152, V. 1925, D. 166, fl. 193, Telegram i Kryetarit të Republikës A. Zogu, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë, 7 janar 1926; *po aty*, F.155, V. 1926, D. IX-24, fl. 1, Telegram i Kryetarit të Republikës, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë 1 tetor 1926.

<sup>46</sup> *Po aty*, F. 271, V. 1926, D. 26, fl. 2, Telegram i Ministrisë së Punëve të Brendshme, drejtuar prefekturës së Elbasanit, Tiranë 24 janar 1926.

<sup>47</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1925, D. 4, fl. 7, Propozim i S.Paparistos, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë, 27 prill 1925.

<sup>48</sup> *Po aty*, fl. 13, Mbi formimin e komisionit teknik pranë DPA. Tiranë, 4 qershor 1925.

<sup>49</sup> *Po aty*, fl. 16, Rregullore e veprimit të komisionit teknik, Tiranë 11 korrik 1925.

komisionit teknik u caktuan Z. Fekeqi dhe Karl Gurakuqi, të cilët do të merreshin me përgatitjen e teksteve shkollore, të rregulloreve e projekteve të nevojshme për riparimin e konvikteve etj. Për punën e bërë ata do të paguheshin nga fondet e parashikuara në buxhetin e DPA.<sup>50</sup>

Komisioni teknik kishte si detyrë të trajtonte çështjet më thelbësore që shtroheshin para arsimit kombëtar si: përcaktimi i sistemit arsimor që do t'i përshtatej shtetit shqiptar, përpilimi i programit unik analitik për shkollat fillore të fshatrave, plotore dhe ato të mesme, plotësimi i ligjeve e i rregulloreve arsimore që ishin në veprim. Në kushtet kur në Shqipëri ekzistonin programe mësimore të ndryshëm nga njëri tjetri edhe brenda të njëjtës sistem, ishte e nevojshme të unifikohej një sistem arsimor kombëtar në të gjithë vendin, ku të përcaktoheshin qartë nivelet arsimore, fillor dhe i mesëm, i përgjithshëm e profesional dhe, brenda niveleve përkatëse të zbatoheshin një program analitik unik. Në këtë mënyrë do të bëhej i mundur formatimi i një sistemi arsimor unik kombëtar të cilit do t'i nënshtroheshin jo vetëm shkollat shtetërore por edhe ato të minoriteteve e ato private. Ky sistem do të bënte të mundur rritjen e ndërgjegjes kombëtare, forcimin e unitetit kombëtar, do të pengonte depërtimin e influencave të huaja dhe do të kontribuonte në zhvillimin e konsolidimin e shtetit shqiptar.

Reforma kërkonte përgatitjen e bazës ligjore mbi të cilën do të organizohej sistemi arsimor kombëtar. Prandaj një nga detyrat që u shtrua para komisionit teknik, ishte hartimi i projektligjit mbi kategorizimin e arsimtarëve. Thelbi i këtij projektligji ishte vendosja e kriterëve për emërimin e arsimtarëve, përcaktimi i masës së pagës së tyre në përputhje me arsimin, kualifikimin e specializimin profesional sipas vjetërsisë, përvojës, rezultateve në punë, posteve që mbanin etj. Në të njëjtën kohë, ai do të shërbente si bazë për unifikimin e sistemit arsimor kombëtar shqiptar. Projektligji u diskutua dhe u miratua në seancën parlamentare të 31 marsit 1926.<sup>51</sup>

Deri në këtë kohë, në sistemin arsimor shqiptar punonin mësues me nivel arsimor tepër heterogjen. Në shkollat fillore, të cilat përbënin numrin më të madh në sistemin shkollor, jepnin mësim arsimtarë, një

<sup>50</sup> *Po aty*, fl. 18, Vendim i Këshillit të Ministrave, Tiranë, 13 nëntor 1925.

<sup>51</sup> *Po aty*, F. 146, V. 1926, D. 97, fl. 476, Mbledhja e 18-të e dhomës së deputetëve, 31 mars 1926, fl. 268; *Fletorja Zyrtare* nr. 71, 21 prill 1926, fl. 106-109. Ligji për kategorizimin e arsimtarëve.

pjesë e mirë e të cilëve kishin kryer vetëm shkollën fillore ose në rastin më të mirë shkollën plotore. I njëjti shqetësim ndihej edhe te mësuesit e shkollave të mesme, ndër të cilët kishte me arsim të mesëm e të lartë të paplotësuar. Për të patur një pasqyrë të saktë e të qartë të nivelit arsimor të mësuesve, ligji detyronte të gjithë arsimtarët të paraqitnin dokumentet zyrtare për shkollën e kryer. Mësuesve që u mungonin diplomat dhe nuk mund t'i vërtetonin ato, ligji u jepte të drejtë për të dhënë provimet përkatëse e për t'i pajisur me diplomë. Ndërsa aftësia pedagogjike do të vlerësohej nga një komision i posaçëm. Për mënyrën e organizimit dhe dhënies së provimeve do të hartoheshin rregullore të veçanta. Sipas ligjit (art. 4 e 5), provimeve duhej t'i nënshtroheshin edhe mësuesit e emëruar rishtazi si në shkollat e shtetit dhe ato private. Përfshiheshin nga provimi ata mësues që kishin kryer gjimnazin apo normalen dhe kishin 5 vjet vjetërsi në punë në shkollat shtetërore dhe ato private.<sup>52</sup> Senati propozoi që në këtë nen të përfshiheshin edhe mësuesit me gjimnaz e normale të pambaruar, që kishin kontribuar në arsimin kombëtar qysh pas Shpalljes së Pavarësisë, me eksperiencë mësimit 8 vjeçare, të vlerësuar në raportet e inspektorive të arsimit ose me libra shkollore të pranuar e të botuara nga MA, etj.<sup>53</sup> Po në këto nene përcaktohej se, të gjithë ata mësues që kalonin provimin e aftësisë në një shkollë normale të shtetit, u jepej e drejta për të kaluar në një kategori më të lartë nga kategoria ekzistuese. Për ata mësues që nuk u nënshtroheshin provimeve brenda një afati 4 vjeçar pas emërimit, artikulli i 6-të parashikonte pushimin nga puna për shkak paaftësie. Ata që nuk kalonin provimet u jepej edhe një mundësi për të përsëritur provimin.<sup>54</sup>

Projektligji përcaktonte në mënyrë të hollësishme kategorizimin e arsimtarëve sipas cikleve shkollore. Në arsimin fillor mësuesit ndaheshin në 5 kategori sipas arsimit përkatës. Secilës kategori i korrespondonte paga e caktuar. Në kategorinë e parë bënin pjesë të gjithë arsimtarët me arsim fillor. Ata paguheshin 100 fr.ar. Në kategorinë e dytë, hynin ata që kishin kryer një shkollë qytetëse, me pagë 120 fr.ar. Në kategorinë e tretë, hynin mësuesit që kishin kryer gjysmë gjimnaz ose gjysmë normale, me pagë 150 fr.ar si dhe ata që kishin mbaruar normalen por që nuk kishin

<sup>52</sup> *Po aty.*

<sup>53</sup> *Po aty*; AQSH, F.155, V.1926, D. IX-26, fl. 2-5, Ligj mbi kategorizimin e arsimtarëve.

<sup>54</sup> *Po aty.*

stazh pune. Paga e tyre ishte 160 fr.ar. Në kategorinë e katërt, futeshin arsimtarët me një vit lice të papërfunduar, me pagë 180 fr. ar. Këtu bënin pjesë edhe arsimtarët që kishin mbaruar normalen e shtetit, liceun dhe kishin eksperiencë në punë. Paga e tyre ishte 200 fr. ar. Në kategorinë e pestë, përfshiheshin arsimtarët që kishin përfunduar një shkollë normale të huaj, të rregullt me provim aftësie. Ata do të paguheshin 220 fr.ar. Me qëllim që mësuesit, krahas mësimdhënies të bënin përpjekje për aftësimin e tyre profesional, në artikullin e 5-të të ligjit parashikohej rritja e pagës për çdo katër vjet, deri në njëzet vjet vjetërsi mësimdhënie. Për përfitimin e shtesave, mësuesit duhej tu nënshtroheshin provimeve të kualifikimit profesional.<sup>55</sup> Në artikullin e 11-të, arsimtarët e shkollave të mesme, sipas arsimit që kishin kryer, ndaheshin në tre kategori. Pagat ishin 250 fr. ar për kategorinë e parë, 280 fr. ar për të dytën dhe 300 fr. ar për kategorinë e tretë. Aty parashikoheshin edhe shtesat në çdo katër vjet për çdo kategori.<sup>56</sup>

Ligji u dekretua më 12 prill 1926.<sup>57</sup> Ai u prit mirë nga mësuesit. Zbatimi i tij do të rriste autoritetin e mësuesit dhe përbënte për ta një inkurajim moral duke i dhënë secilit vendin e merituar. Ai do të përmirësonte gjendjen e tyre financiare e cila, sipas mësuesit V. Xhaçka, ishte as pak e kënaqshme. “Shumica e tyre,- shprehej ai,- e kryejnë detyrën duke u mbështetur më tepër mbi idealet e larta të misionit se sa në shpërblimin e tyre lëndor”<sup>58</sup>.

Ligji u parashikua të zbatohet në vitin shkollor 1926-1927. Por, zbatimi i tij haste në vështirësi, sepse rregullimi i pagave siç e parashikonte ligji, përbënte një faturë të madhe financiare e cila ishte e papërbalueshme për buxhetin e varfër të shtetit si dhe për faktin se arsimtarët pa arsimin përkatës duhej të linin vendet e punës, çka dëmtonte procesin mësimor.<sup>59</sup> Madje, një grup prej tyre, zhvilluan një protestë para DPA ku kërkuan moszbatimin e ligjit.<sup>60</sup> Ndërsa mësuesi Gj. Mikeli, duke vlerësuar dobinë që sillte ligji, theksonte se “zbatimi i tij do të largonte këtë kategori mësuesish nga arsimit dhe do ti sillte kursime

<sup>55</sup> *Po aty.*

<sup>56</sup> *Po aty.*

<sup>57</sup> *Ligje, Dekretligje, rregullore të vjetit 1926*, Vol 3, Botime të Këshillit të Shtetit, Tiranë: 1938, f. 6.

<sup>58</sup> *Gazeta Telegraf*, nr. 31, viti 1927, 25 maj 1927, f. 2.

<sup>59</sup> *Po aty*, nr. 66, 28 shtator 1927, f. 3. “Pse duhet zbatue ky ligj”.

<sup>60</sup> *Po aty.*

buxhetit, që do të rregullonte pagat e arsimtarëve ashtu siç e parashikonte ligji.”<sup>61</sup>

Në të njëjtën kohë, u hartua edhe projektligji organik mbi arsimin. Për hartimin e tyre përgatitësit u mbështetën në përvojën e shkollës perëndimore. Kryesia e Dhomës së Deputetëve ia paraqiti parlamentit për diskutim, më 24 prill 1926 dhe u miratua prej tij po atë ditë.<sup>62</sup> Ligji organik ashtu si dhe ligji për kategorizimin e arsimtarëve, përbënin thelbin e reformës arsimore në vitet 1925-1928.

Ligji përcaktonte organizimin e institucioneve arsimore dhe mënyrën e administrimit të arsimit kombëtar. Zbatimi i tij do të realizonte krijimin dhe forcimin e një sistemi arsimor unik kombëtar. Sipas ligjit baza e arsimit në Shqipëri ishte shkolla fillore, e cila ishte hallka e parë dhe më masive e arsimit. Prandaj në raportin shoqërues të projektligjit theksohej domosdoshmëria për organizimin e një sistemi të vetëm fillor me një tip shkolle të unifikuar në të gjithë vendin. Në këtë sistem fëmijët do të merrnin arsimin fillor të mjaftueshëm për nevojat shoqërore e private.<sup>63</sup> “Shkolla e jonë, - theksonte raporti,- duhet të përpiket të zgjojë ndjenjën kombtare tue i dhënë brezit të ri një edukatë të fortë, një kulturë sipas nevojave të sotme të jetesës.”<sup>64</sup> Kjo do të arrihej me përmirësimin e përbajtjes të programeve e teksteve shkollore duke realizuar një sistem arsimor të organizuar e të kontrolluar nga shteti. Në kushtet e ekzistencës së analfabetizmit në nivel shumë të lartë pothuajse në të gjithë vendin, ligji përcaktonte arsimin fillor të detyrueshëm për fëmijët (djem e vajza) të moshës 6-13 vjeç. Për zbatimin e tij do të angazhoheshin struktura arsimore dhe ato të pushtetit lokal.<sup>65</sup> Shkolla fillore parashikohej të ishte gjashtë klasëshe. Ato do të ngriheshin si në qytet dhe në fshat, ku numri minimal i fëmijëve ishte 25.

Të ndërgjegjshëm për vështirësitë që do të haste shtrirja e shkollës plotore në fshatra ku shkollat fillore ishin 2 deri në 4 klasëshe, për shkak të mungesës së mësuesve e ambienteve shkollore, të sigurimit të numrit të domosdoshëm të nxënësve dhe të mundësive të kufizuara financiare, përgatitësit e ligjit parashikuan që kjo të realizohej brenda një afati 10-

<sup>61</sup> *Po aty.*

<sup>62</sup> *AQSH*, F.149, V.1926, D. IV-146, fl. 3-26, Projektligji organik mbi arsimin, miratuar nga Dhoma e Deputetëve më 24 prill 1926.

<sup>63</sup> *Po aty.*

<sup>64</sup> *Po aty.*

<sup>65</sup> *Po aty.*

vjeçar. Me sigurimin e kuadrit të nevojshëm arsimor gjatë kësaj periudhe, do të bëhej e mundur që këto shkolla të unifikoheshin si shkolla plotore.

Për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve të fshatrave të largëta, ligji parashikonte ngritjen dhe funksionimin e konvikteve si dhe emërimin e mësuesve shëtitës.

Gjithashtu ligji parashikonte edhe funksionimin e arsimit parashkollor për moshat 2 deri në 6 vjeç. Kjo hallkë e arsimit, që quhej foshnjore, do të ngrihej pranë shkollave femërore ose do të ishte pjesë e tyre, ku vajzat do të ushtronin praktikën pedagogjike.

Në ligj, vend i veçantë i kushtohej shkollës normale si pjesë e rëndësishme e arsimit kombëtar. Ajo konsiderohej "burimi dhe shpirti i arsimit fillor."<sup>66</sup> Shkollat normale futeshin në kategorinë e arsimit të mesëm. Ato ishin femërore dhe mashkullore, me program pothuajse të njëjtë. Shkollat normale ishin të pajisura me konvikte, për t'u krijuar mundësi studimi dhe kushte jetese, nxënësve të ardhur nga të gjitha viset shqiptare, veçanërisht atyre të fshatit për t'i përgatitur si mësues për shkollat e katundeve dhe të malësive.

Në kategorinë e arsimit të mesëm përfshihej gjimnazi dhe liceu me cikël studimesh 3 dhe 4 vjeçare, gjithsej shtatë vjet, me degë klasike dhe moderne. Ligji përcaktonte kriteret që duhej të plotësonin një nxënës për të ndjekur shkollën e mesme. Ai duhej të kishte kryer shkollën fillore 5 vjeçare, ndërsa nxënësit që kishin përfunduar shkollën fillore me cikël 6 vjeçar kishin të drejtë të regjistroheshin në vitin e dytë të gjimnazit.

Meqenëse personeli arsimor i posaçëm dhe tekstet mësimore në gjuhën shqipe për shkollën e mesme, ishte e vështirë të siguroheshin menjëherë, në ligj parashikohej që edhe për disa vjet të mbaheshin shkollat lice në gjuhë të huaj në Korçë dhe Gjirokastër, të cilave pas vitit të katërt, mund t'u shtohej nga një degë normale me studime letrare e shkencore në gjuhën shqipe, për të përgatitur profesorët e shkollave të mesme. Shkolla e mesme 7-vjeçare, do t'u krijonte mundësi nxënësve të arsimoheshin brenda vendit, gjë që do t'u vlente "si për anën edukative dhe atë ekonomike."<sup>67</sup>

Në ligj përcaktohej programi i unifikuar për shkollën fillore, të mesme dhe normale si dhe kriteret që duhej të plotësonin mësuesit për t'u emëruar.

---

<sup>66</sup> *Po aty.*

<sup>67</sup> *Po aty.*

Programi për shkollën fillore pesëvjeçare u siguronte fëmijëve një informacion dhe formim fillestar të shumanshëm në lëndët shoqërore për mësimin e shkrimit e gjuhës shqipe, e të historisë së Shqipërisë, në shkencat natyrore dhe në pajisjen e tyre me shprehje praktike për punët e përditshme në familje, veçanërisht në ekonominë shtëpiake e në bujqësi.<sup>68</sup> Ndërsa ai i gjimnazeve dhe liceve, përfshinte një gamë të gjerë lëndësh, që u ofronin nxënësve njohuri të thella e komplekse të mjaftueshme për formim të shëndoshë në shkencat shoqërore e ato natyrore si dhe u krijonin mundësi të shprehnin talentin dhe dëshirën për muzikën, pikturën e sportin.<sup>69</sup> Programi i shkollave normale synonte pajisjen e nxënësve me njohuri në fushën e pedagogjisë e psikologjisë aq të domosdoshme për mësuesit por edhe me njohuri të shkencave shoqërore dhe natyrore, për të qenë të aftë për edukimin e brezave të rinj.<sup>70</sup>

Ligji organik përcaktoi edhe strukturën e administratës arsimore me pagat përkatëse për çdo funksion të saj. Sipas ligjit, DPA ishte autoriteti më i lartë arsimor në vend. Ajo drejtonte të gjithë veprimtarinë e sistemit arsimor për zbatimin e ligjeve dhe përgjigjej për të gjithë problematikën administrative dhe financiare të tij. Paga e drejtorit ishte 500 fr ar. Ajo mbetej në vartësinë e Ministrisë së Drejtësisë dhe përbëhej nga dy degë. Dega A ndiqte veprimtarinë e institucioneve të mesme dhe dega B atë të institucioneve fillore. Pjesë e strukturës së DPA ishte edhe komisioni

<sup>68</sup> *Po aty*, fl. 796. Programi për shkollën fillore 5-vjeçare përmbante: Dijeni morale e qytetore; Këndim e shkrim të gjuhës shqipe; Gjuhë (didaktikë, gramatikë e hartim); Aritmetikë dhe elemente gjeometrikë; Histori e kombit shqiptar dhe ngjarje ma me rëndësi nga historia e përgjithshme; Gjeografi; Elemente të shkencave natyrore e fizike me zbatime në bujqësi e higjienë; Vizatim; Këngë; Punë-dore, ekonomi shtëpiake; Gjymnastikë; Punë praktike në bujqësi.

<sup>69</sup> *Po aty*, fl. 802. Programi i gjimnazeve dhe i liceve, ishte i njëjtë. Ai përmbante: Gjuhë-letërsi; Matematikë; Histori; Gjeografi; Histori natyre; Dituri natyre; Greqishte e vjetër; Latinisht; Gjuhë të gjalla; Elementë të filozofisë; Elementë të ekonomisë politike e drejtësisë; Kaligrafi e vizatim; Muzikë; Gjymnastikë.

<sup>70</sup> *Po aty*, fl. 803. Programi përmbante: Pedagogji, (psikologji intuitive, didaktikë e përgjithshme dhe e veçantë, histori e pedagogjisë, hospitinë e prova mësimi); Dijeni civile; Gjuhë e letërsi; Gjeografi dhe elementë të ekonomisë politike; Histori; Matematikë; Histori natyre e higjienë; Dituri natyre; Bujqësi teorike e praktike; Gjuhë e gjallë; Këngë e violinë; Punëdore; Vizatim gjeometrik; Gjymnastikë e sport.

teknik i cili do të merrej me hartimin e teksteve për shkollat e mesme dhe fillore, për të cilat ligji për herë të parë parashikonte organizimin e konkurseve, shpërblimin e autorëve dhe të përkthyesve.<sup>71</sup> Në organikën e DPA, ishte inspektorja e përgjithshme. Në përputhje me buxhetin financiar, ligji parashikonte mbështetjen me bursa të nxënësve brenda dhe jashtë vendit, etj.<sup>72</sup> Për të ndjekur ecurinë e studentëve në vende të ndryshme, u parashikua ngritja e zyrës së inspektorëve. U ringrit përsëri drejtorja e muzeut dhe bibliotekës. Në prefektura ligji sanksiononte funksionimin e drejtorive arsimore me inspektoritë përkatëse.

Ligji organik megjithëse u miratua nga organet legjislativë më 24 prill 1926, me ndryshime të vogla, u dekretua nga Presidenti i Republikës më 27 qershor 1928.<sup>73</sup>

Ashtu si ligji për kategorizimin e arsimtarëve edhe ai organik nuk u zbatua menjëherë në mënyrë tërësore por pjesë-pjesë. Arsyet kryesore ishin mungesa e kushteve ekonomike e financiare, infrastrukturore e njerëzore për të realizuar zbatimin e tyre të plotë.

Megjithatë DPA, e drejtuar nga S. Papahristo, Pertef Pogoni, deri në qershor të vitit 1927, krahas përgatitjes së bazës ligjore, u angazhuan për zbatimin e saj dhe brenda mundësive që u lejonte buxheti, t'u jepnin zgjidhje disa prej çështjeve më të domosdoshme të arsimit. Para së gjithash ajo e drejtoi vëmendjen tek personeli ekzistues arsimtar sidomos në drejtim të aftësisë profesionale. Gjatë vitit 1925, organizoi kurse kualifikimi pothuajse në të gjitha prefekturat si në atë të Shkodrës, Kosovës, Dibrës, Beratit, Vlorës, Kavajës, Elbasanit, Gjirokastrës, Korçës etj., për të gjithë mësuesit e shkollave fillore që nuk kishin kryer shkollën të posaçme për mësuesi.<sup>74</sup> Sipas të dhënave të drejtorive arsimore, frekuentimi i kurseve nga mësuesit ishte i kënaqshëm. Vetëm në qarkun e Korçës numri i tyre arriti në 101.<sup>75</sup> Por, pati raste si në prefekturën e Beratit në qendër, ku 4 mësuese nuk pranuan të ndiqnin

<sup>71</sup> *Po aty.*

<sup>72</sup> *Po aty.*

<sup>73</sup> *Fletorja zyrtare*, nr. 82, 4 gusht 1928; shih edhe në: *Ligje, Dekretligje, rregullore të vjetit 1928*, Vol V, Botime të Këshillit të Shtetit, Tiranë: 1939, f.795.

<sup>74</sup> *AQSH*, F.195, V. 1925, D. 9, Raport i DPA, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, mbi punën për përmirësimin e punës së mësuesve, Tiranë, 5 qershor 1925.

<sup>75</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1925, D. 91, fl. 10-11, Telegram i inspektorisë arsimore Korçë, drejtuar DPA, Korçë, 22 shtator 1925.

kurset për shkak të fanatizmit e konservatorizmit. Qëndrimin bashkë me burrat për të ndjekur mësimet në një kurs, ato e quajtën si “çnderim”<sup>76</sup> Mësuesit që iu nënshtruan provimeve, u pajisën me dëshmi dhe u rikthyen në vendet e punës. Një pjesë prej tyre zëvendësuan mësuesit që nuk iu nënshtruan provimeve. Mesa duket ky kontingjent jo vetëm që nuk zotëronte dokumentacionin justifikues por e ndjente veten të paaftë për të përballuar kërkesat e provimit.<sup>77</sup> Një praktikë e tillë kualifikimi për arsimtarët, u sanksionua në nenet e ligjit mbi kategorizimin e arsimtarëve të marsit 1926.

Në përputhje me shtimin e buxhetit për arsimin në vitin 1926 (566.134 fr.ar), DPA ngriti konvikte në Dibër, Mat dhe në shkollën ekonomike të Vlorës, për tu krijuar mundësi shkollimi fëmijëve në zonat e thella malore.<sup>78</sup> U kujdes për shtimin e klasave të gjashta në shkollat plotore pesëvjeçare, si dhe implementimin e programit të unifikuar kombëtar në sistemin shkollor shtetëror dhe privat. Në vitin 1925, u ngritën dy gjimnaze në Berat dhe në Tiranë dhe gjysmë gjimnaze në qytete të ndryshme të vendit.<sup>79</sup> Nën kujdesin e saj, u hartuan disa rregullore për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe në organizimin e shkollave, shfrytëzoi buxhetin e caktuar për botimin e librave shkollorë etj. Në bashkëpunim me komisionin teknik u shqyrtuan dorëshkrimet për librat e paraqitura për botim në përputhje me programin e ri shkollor, një pjesë e mirë e tyre tashmë kishte parë dritën e botimit.<sup>80</sup>

Për plotësimin e kërkesave në rritje për mësues, DPA riktheu në detyrë arsimtarë që ishin pushuar nga puna, si dhe u emëruan ndihmës mësues, të cilët duhej t’u nënshtroheshin provimeve, nëse nuk e kishin përfunduar shkollën. Paga e tyre nuk do t’i kalonte 80 fr.ar në muaj.<sup>81</sup>

<sup>76</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1925, D. 9, fl. 10, Raport mbi ecurinë e kurseve për të përmirësuar punën e arsimtarëve në shkollat fillore, Berat 12 qershor 1925.

<sup>77</sup> *Po aty*.

<sup>78</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ)*, V. 1927, D. 204, fl. 1, Qarkore e DPA, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme. Statistikë për vitin shkollor 1926-1927.

<sup>79</sup> *Gazeta Dielli* 4025 (718) 2 dhjetor 1927, f. 4. Intervistë e Ministrit të Arsimit, Xhafer Ypi, dhënë në: *Gazeta Shqiptare*, Bari, Itali.

<sup>80</sup> *Po aty*.

<sup>81</sup> *AQSH*, F. 149, V. 1926, D. IV-145, fl.16, Kërkesë e drejtorit të përgjithshëm Pertef Pogoni drejtuar Këshillit të Ministrave, Tiranë 23 maj 1926; Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 188, Tiranë, 10 qershor 1926.

Gjithashtu DPA, i kërkoi qeverisë franceze njësimin e diplomave për nxënësit e Liceut të Korçës, për tu krijuar atyre lehtësi për të ndjekur studimet në universitetet e Francës.<sup>82</sup> Në ndihmë të nxënësve dhe mësuesve si dhe për të pasuruar jetën kulturore të kryeqytetit, në Tiranë u çel libraria “Lumo Skëndo & Kristo Luarasi” me libra shqip dhe të huaj.<sup>83</sup>

Për të ndihmuar arsimin shtetëror, DPA hartoi projektligjin për çeljen e instituteve arsimore private.<sup>84</sup> Ky projektligj synonte që arsimi privat nga parashkollor e deri te ai i mesëm, të vihej nën zotërim të shtetasve shqiptarë dhe veprimtaria arsimore e tyre të kontrollohej nga shteti. Zbatimi i tij do të frenonte ndikimin e huaj dhe veçanërisht atë të vendeve fqinje në sistemin arsimor kombëtar. Kjo përcaktohej në artikullin 1, 2 dhe 8 të projektligjit, ku theksohej, se “mund të çelëshin shkolla private foshnjore, profesionale të mesme me internate private të drejtuara nga persona të kualifikuar, nështetas shqiptarë. Asnjë nënshtetas ose organizatë e huaj, nuk mund të hapte shkollë private në Shqipëri”.<sup>85</sup> Por projektligji përcaktonte se një shoqëri bamirëse e huaj mund të hapte një shkollë profesionale ose strehë vorfënore bashkë me shkollë, vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave.<sup>86</sup>

Megjithë përpjekjet që u bënë nga DPA, gjendja në fushën e arsimit në Shqipëri mbetej e vështirë. Në qershor të vitit 1927, parlamenti i kushtoi kësaj çështjeje një seancë të veçantë, ku u pranua se ai ishte në gjendje të mjeruar dhe duheshin marrë masa serioze për përmirësimin e tij.<sup>87</sup> U kërkua çelja e shkollave të reja dhe shpërndarja e tyre në mënyrë proporcionale me popullsinë e qarqeve, u trajtua problemi i mungesës së arsimtarëve dhe u propozua që të shtoheshin shkollat normale për përgatitjen e mësuesve të aftë. Parlamenti vendosi që një pjesë nga fondi

---

<sup>82</sup> *AMPJ*, V. 1926, D. 213, fl. 1, Kërkesë e Drejtorisë së Përgjithshme Arsimore drejtuar qeverisë franceze, Tiranë, 7 janar 1926.

<sup>83</sup> *AQSH*, F. 35, V. 1925, D. 168, Njoftim për hapjen e librisë “Lumo Skëndo & Kristo Luarasi”, Tiranë, maj 1926.

<sup>84</sup> *AQSH*, F. 195, V. 1926, D. 26, fl. 2-4, Projektligj mbi çeljen e shkollave private në Shqipëri. Viti 1926.

<sup>85</sup> *Po aty*.

<sup>86</sup> *Po aty*.

<sup>87</sup> *AQSh*, F. 146, V. 1927, D. 93, fl. 353, Procesverbal i bisedimeve parlamentare, Tiranë, 2 qershor 1927.

prej 300.000 fr. ar për arsimin, t'i jepej Normales së Elbasanit dhe asaj të Korçës për ngritjen e godinave të reja.<sup>88</sup>

Gjendja arsimore u trajtua gjerësisht edhe në revistën “Mësuesi”. Gj. Mikeli, në artikullin “Arsimi, lulzimi i shtetit”, konstatonte se, rrjeti shkollor i shtrirë në vend nuk kishte sjellë gjë tjetër veçse një luftë të thjeshtë kundër analfabetizmit, “duke i dhënë të gjithë veprimit arsimor një fytyrë kulturore sipërfaqore e më tepër të rrejshme.”<sup>89</sup> Përmirësimin e gjendjes në arsim ai e shihte te korrigjimi i të metave në personelin arsimor, kërkonte largimin e mësuesve pa arsimin përkatës, dhe sidomos të atyre me shkollë fillore që sipas tij “... nuk kanë se ç’tu mësojnë të tjerëve.” Vëmendje të veçantë i kushtonte përmirësimit të librave shkollorë duke i hartuar ato sipas parimeve të psikologjisë e të metodikës, të përmirësohej mënyra e të shkruarit të tyre duke u larguar nga dialekti me bazë gegërishten, në mënyrë që ato të kuptoheshin edhe në shkollat e krahinave të Jugut.<sup>90</sup>

(vijon)

### *S u m m a r y*

#### EDUCATION IN ALBANIA AND THE MEASURES UNDERTAKEN TO IMPROVE IT (1925-1928)

The focus of this paper is Albanian education from 1925 to 1928 and it gives an overview of the country's educational system and the issues related to it. Some of the main difficulties that the education system faced were a limited network of schools, a lack of teachers or teachers with a low professional and educational training, a low budget issued to education, a high level of illiteracy in general and in rural areas in particular, etc.

Although the education system was facing such hardships, A. Zogu took measures to fire the teachers that had been part of or had supported the movement that took place in June 1924 against him. However, later on, due to the need that the education system had, these measures were softened and many

<sup>88</sup> *Po aty*; gazeta *Dielli* nr. 3099 (692), 2 shtator 1927, f.3.

<sup>89</sup> *Revista Mësuesi*, nr. 1-2, Viti 1927, f.12-14.

<sup>90</sup> *Po aty*.

teachers who had been fired were hired again. This paper deals with the endeavors done for the opening of new schools, the improvement of the conditions in the existing ones, the engagement of the government and the education directorate to organize courses for the training and improvement of the teachers and the implementation of the reform in education which aimed at building a unified national education system. In order to fulfill the education reform there were prepared, discussed and approved two new education laws and there were made serious attempts to implement them. The law on classifying the teachers was approved in 1926. It defined the educational and professional requirements a teacher should fulfill in order to be hired. This legal requirement obliged the teachers to attempt their educational and professional enhancement and at the same time forced the teachers who did not fulfill the requirements leave the education system. The law also set the teachers wages based on the requirements they fulfilled. This measure motivated the teachers to continuously want to further their professional skills and achieve high results at work. On the same year was drafted and approved the law on the structure of the education system. This law clearly defined the organization of the education institutions and the way the education system was to be administered in the whole country. According to it, education started with the elementary schools which were obligatory for all boys and girls up to 12 years old, continued with the civic or intermediary schools, and later on, the general training middle schools or the vocational ones such as pedagogical, agricultural, etc. Considering the serious lack of teachers, the law promoted the pedagogical education and especially its attendance by girls. Another issue covered by this law was the curricula that would be used in schools across the country. The whole education system would implement unified programs which aimed at providing the pupils with long lasting knowledge in the scientific and social subjects and at the same time raising their national awareness.

